

Si e lexova Kur`anin e parë shqip në burgun e Prishtinës

Si e lexova Kur`anin e parë shqip në burgun e Prishtinës në vitin 1986

Pas përfundimit të hetimeve dhe pasi u dënova nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me 4 vite e 6 muaj burg për nacionalizëm, irredentizëm e shovenizëm(bëhet fjalë për burgun e parë) e që në fakt e vërteta ishe vetëm pse kërkuam që Kosova të jetë Republikë, pas shqiptimit të dënimit, mori udhë një rrugë tjetër. Tanimë duhej që ta vuaja dënimin si armik i shtetit jugosllav bashkë me shokët e mi.

Pas hetimeve gjashtë mujore, nga burgu i Gjilanit më transferuan në atë të Prishtinës. Edhe pse na dënuan, neve na mbanin në burg hetues e që i bie natë e ditë je i mbyllur si në një kafaz. Dritën e diellit e shihnim vetëm dy herë në ditë e që nuk kalonin dyjat së bashku 20 minutëshin. Por, me që temën e kemi diku tjetër, nuk do të shkruaj për jetën e burgut hetues.

Ne të burgosurit e politikës, vazhdimisht kishim probleme me libra. Në fakt neve nuk na lejonin që dy shokë të politikës të qëndronim bashkë, por brenda një dhome ishte vetëm një i burgosur politik, pastaj tre të tjerët ishin për dhunim, vjedhje ose vrasje. Ndërtimi ynë jetësor dhe qëllimet liridashëse që kishim, nuk përputheshin me të burgosurit ordiner, andaj shpëtimi ynë ishte në botën e librit. Burgu kishte një bibliotekë, por jo të gjithë librat i preferonim për lexim sepse ishin me përmbajtje jugosllave. Librat që kërkonim nga shtëpia i cenzuronin dhe në shumicën e rasteve na i kthenin mbrapsht…

Para se të bija në burg, vëllau im tanimë i ndjerë Seferi, bleu Kur`anin. Ishte hera e parë që botohej Kur`ani në gjuhën shqipe. Ate e përktheu Dr. Feti Mahdiu, ndërsa e botoi Shtëpia Botuese Rilindja. Kur`ani u botua kah mesi i vitit 1985.

Dhe një ditë me lindi ideja që ta lexoj Kur`anin. Në vizitën e radhës i kërkova vëllaut që t`ma sjell librin e shenjtë. Në vizitën e radhës, ma solli atë. E dinim që disa ditë duhej pritur që të kalon cenzurën e burgut, por Kur`ani nuk më erdhi as pas dy jave, as pas tri jave, kështuqë krijova

bindjen se nuk ma kanë lejuar autoritetet e burgut (UDB-së) dhe e kanë kthyer .

Por, pas një muaje e disa ditë, u hap dera e qelisë nr. 19 dhe ,,edukatori'' më solli Kur`anin. Nuk ma tha asnjë fjalë, vetëm më tha merre! Sinqerisht u gëzova shumë. Tani kjo dhomë në burgun muze të Prishtinës bart numrin 13, pasiqë nga dy dhoma të ish burgut të asaj kohe, pas vitit 1999 është bërë një dhomë, është bërë zgjerimi i tyre.

Në familjen time, natyrisht se praktikohej besimi, por tek ne të rinjët s`mund të them se dinim më shumë se formalja, më shkurt kjo komponentë e njohurive më mungonte shumë, tepër shumë dhe këtë duhet ta plotësoja, por tanimë në rrethana burgu.

Dhe pavarësisht kushteve tepër të rënda që kishim , në këtë rast higjenike, fillova leximin, meditimin dhe studimin e Kur`anit, siç thashë më lartë të përkthyer nga Feti Mehdiu. Koha e leximit të Kur`anit ishte e gjatë dhe e lexova disa herë, por Kur`ani i përkthyer nuk kishte komentim që t`ma lehtësonte kuptimin. Megjithate, arrita të kuptoj aq sa munda. Në rrjedhë të leximit më lindi ideja që ato që kuptova t`i shndërroj në formë poezie, në formë poeme, disi t`i materializoj. Meqë laps e letër të përhershëm nuk kishim, strofat e poezisë i,,shkruaja'' në mbamendje.

Më poshtë do ta shkruaj poezinë, por që në fakt nuk është e tëra e burgut, sepse kohë pas kohe dhe vende vende është përmirësuar, por thelbi dhe fryma e poezisë është po ajo e dhomës numër 19 dhe numër 4 të burgut të Prishtinës.

Ndërsa koha se kur u shkrua kjo poezi është nga vjeshta e vitit 1986 e deri në fund të vitit 1987.

1.

Nëse nuk ndahesh, nuk bashkohesh kurrë

Njëherë bëhu gurë, pastaj bëhesh murë

Bëhu trëndafil se të mbetet aroma

Ferra ka vetëm xhemba, mos thuaj u therrova!

2.

Bëhu tokë e plleshme të rritet bimësia

Të ushqehen zogjtë, të ngopet uria

Ikë nga e keqja, zjarri është brenda sajë

Vrapo pas Njëshit, dritën ke për të parë!

Bëhu fjalë e mirë, ndaç që të jetosh gjatë

Fjala që del nga zemra, ajo është uratë

Fjala e mirë është urë, ajo lidh dhe brigje

Fillo me emrin e Tij, zemra gufon me gëzime.

3.

Kur dole nga barku e qajtura ishte fjala jote

Nga një botë dilje, për të shijuar një botë tjetër

Me kohë ngritesh në këmbë e fillon të ecësh

Para ke një rrugë të gjatë, mjer ai kush ngecë!

4.

Shndërrohu në gjurmë, jeta është ditar

Ti je vet e mira, Zoti të ka falë

Kujdes në udhëkryq, aty ku ndahet shapi

Ec fushës së gjërë, largohu nga shpati!

5.

Bashko ballin me tokën, aty do të lartësohesh

Është pika që të ndritë, aty me nurin takohesh

Aty ku trupi harkohet e s`është më vijë e drejtë

Aty është hareja, që të ndritë për jetë.

Aty thehet errësira e mendjemadhësia

Në përulje ngritesh i Gjalli të përqafon

Futesh në botën e madhe e që fund nuk ka

Ku i Gjithëfuqishmi sundon, emri i Tij, Allah.

6.

Ecë Luginës së Tuvasë si dikur Musaja

Kërkoj gjurmët e mëshirës nga Kodra Tur

Shpirti ndjen nevojë, me ballë kthyer nga Qabeja

Ai që pastrohet, fytyra i bëhet nurë.

7.

Rreth shtëpisë së Tij, tavafin bëj me radhë

Madhëroj të Lartësuarin që vështron mbi Arsh

Gjej ferkemët e Halilit, që as zjarri se dogji

Bashkë me të birin e tij, që flijimin provoi.

8.

Bashkë me Jusufin, bashkëjetoj në qeli

Drita e bukurisë, kthyer ishte në vuajtje të padrejtë

Vitet i kalonte e ëndërrat ua komentonte shokëve të tij

Dhe një ditë, rrjedhi sebepi, doli nga burgu i zi.

9.

Ditën e mbështjelli nata, e të burgosurit janë në gjumë të thellë

Ngritem nga shtrati pas mesnate, në pjesën e tretë

I ngris duart lartë, me fjalë e me zemër

Flas me të Pagjumin, ashk e lot, tretur.

P.S. Fotografia në kopertinë është e vitit 2025 në dhomën e burgut muze të Prishtinës, aty ku kam lexuar Kur`anin